



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 201, Datë 23.06.2023

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S Nr. 41, DATË 10.03.2022
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “AGE KUÇ” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KUÇ” ME KAPACITET TË
INSTALUAR 1930 KW”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.06.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1724/2 prot., datë 22.06.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “*Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 41, datë 10.03.2022 “Mbi licencimin e shoqërisë “AGE KUÇ” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “KUÇ” me kapacitet të instaluar 1930 kW”, i ndryshuar*”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 41, datë 10.03.2022, i ndryshuar me vendimin nr. 299, datë 18.11.2022, vendosi të licencojë shoqërinë “AGE KUÇ” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kuç”, me kapacitet të instaluar 1930 kW, për një afat 30 vjeçar, me kusht që të depozitojë në ERE lejen e shfrytëzimit të burimit ujor të rinovuar, brenda 90 ditëve nga data e aplikimit në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), për rinovim.
- ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimmarrje me shkresën nr. 49/15 prot., datë 23.11.2022 duke i sjellë në vëmendje detyrimin për plotësimin e kushtit të vendosur në pikën 2 të këtij vendimi.
- Me shkresën nr. 1397 prot., datë 11.05.2023, ERE i kërkoi AMBU, ndër të tjera, informacion mbi statusin e rinovimit të përdorimit të lejes përkatëse për prodhimin e energjisë nga HEC “Kuç”, të shoqërisë “AGE KUC” sh.p.k.

- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1397/1 prot., datë 19.05.2023, AMBU njoftoi ERE-n se: *aplikimi për rinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujqor për HEC Kuç nga subjekti “AGE KUÇ” është regjistruar në sistem në datën 18.1.2023 dhe aplikimi është në proces trajtimi nga organet e menaxhimit të burimeve ujqore.*
- Gjithashtu, për sa i përket përcaktimit të një afati maksimal brenda të cilit duhet të merret vendimi për miratimin ose jo të kërkesës/aplikimit për leje përdorimi burimi ujqor, AMBU, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 138/1 prot., datë 26.01.2023, sqaroi se: *pavarësisht se vlerësimi progresiv i afateve të vendosura në dispozitat në fuqi është mesatarisht rreth 90 ditë, por për arsye të nevojave të paparashikuara për shkëmbimin e informacionit të nevojshëm me institucionet shtetërore apo proceset e trajtimit në vendimmarrje nga këshillat e baseneve, ky afat, sipas rastit, mund të tejkalojë ndjeshëm atë të parashikuar.*
- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 405/1 prot., datë 10.02.2023 dhe nr. 1724/1 prot., datë 14.06.2023, shoqëria “AGE KUÇ” sh.p.k. ka bërë me dije ERE-n se: *është në pritje të aprovimit të saj nga organet e menaxhimit të burimeve ujqore dhe se me marrjen e kësaj lejeje do të fillojë menjëherë ndërtimin e veprës dhe për këtë do të vendosë menjëherë në dijëni ERE-n.*
- Gjatë marrjes së vendimit nr. 41/2022, shoqëria “AGE Kuç” sh.p.k. dispononte një leje të vlefshme për përdorimin e burimit ujqor, ndaj i është lënë kushti përkatës për ta depozituar atë në ERE të rinovuar, por duke marrë në konsideratë se nga AMBU nuk është përcaktuar një afat konkret brenda të cilit duhet të përfundojë një procedurë për rinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujqor dhe se shoqëria nuk ka filluar ende të ndërtojë hidrocentralin, vlerësohet të ndryshohet pika 2 e vendimit nr. 41/2022, i ndryshuar, duke i vendosur kusht shoqërisë që të mos fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike pa depozituar në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Kuç”.
- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 41, datë 10.03.2022 , ndryshon dhe bëhet:
2. *Shoqëria “AGE KUÇ” sh.p.k. të informojë ERE-n çdo 2 muaj mbi ecurinë e marrjes së lejes së rinovuar të përdorimit të burimit ujqor për prodhim hidroenergjie nga HEC*

“Kuç” dhe ta depozitohet atë në ERE , përpara fillimit të prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kuç”.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “AGE KUÇ” sh.p.k., Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, “Furnizuesin e Tregut të Lirë” sh.a. dhe “Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI